


KOMUNA RAHOVEC

BULETINI MUJOR KOMUNAL  
SHKURT 2023



## PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE TË DREJTORËVE TË DREJTORIVE.....	3
PËRFUNDIM.....	111

## HVRJE

Ky buletin është krijuar me idenë e promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtoreve gjatë muajve të vittit 2023.

Rrëndësia e botimit të buletinit mujor qëndron në dhënien e mundësisë për informacione mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit, në mënyrë të tillë që t'i mundësojmë qytetarit të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Muaji shkurt i vittit 2023, është karakterizuar me një sërë aktivitetesh të kryetarit dhe të drejtorëve të drejtoreve.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin shkurt, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet e Kryetarit të Komunës dhe të drejtorëve të drejtoreve në Komunën e Rahovecit.


## AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Bashkë me nënkyetarin z. Fatmir Iska dhe zyrtarë të kabinetit, kryetari Latifi priti në takim shefin e Zyrës Ndërlidhëse të Sllovensës në Prishtinë, z. Rastislav Kostilnik. Kryetari e falënderoi shefin për vizitën dhe e njoftoi me veçantitë, të arriturat si dhe mundësitë që ka Rahoveci, poashtu e informoi se Komuna e Rahovecit rangohet shumë lart në performance, transparencë dhe në shume aspekte të geverisjes.

Para z. Kostilnik paraqiti edhe potencialin e madh që ka Rahoveci për investime në shumë fusha, posaçërisht investimet që pritet të bëhen në fushen e energjisë se riprofitshme.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të MBPZHR-së, pas shqyrtimit të ankesës së bazuar në faktet, argumentet dhe dëshmitë e ofruara prej komunës së Rahovecit, ka kualifikuar edhe 243 bujq, te cilet do të dëmshpërblehen për dëmet e pësuar nga vërsimet. Sipas raportit të Drejtorisë Komunale për Bujqësi, i cili po vazhdon të shqyrtohet në MBPZHR, përkatesisht në Komisionin për Ankesat të kësaj ministrie, nga 540 bujq që u janë dëmtuar kulturat e tyre nga fatkeqësítë natyrore, ditë më herët 214 bujq janë kompensuar, kur i shtojmë edhe 243 të kualifikuar që do të kompensohen, neve na mbeten të e vazhdojmë 'betejën', edhe për 83 bujq.



Me vendim të Kryetarit Smajl Latifi, është themeluar Komiteti Komunal Veprues. Komiteti në fjalë përbëhet nga 11 anëtarë. Nën udheheqjen e Nënkyetarit, z. Fatmir Iska, si u paraqiten planet lidhur me sfidat e mëtejme. Detyrat dhe përgjegjësítë e KKV-së derivojnë nga Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Romë dhe Ashkali dhe si qëllim kryesor është integrimi sa më i madh i komuniteteve në shoqërinë tonë.

U mbajt takimi i parë konsultues me anëtarët e Keshillit Organizues për 17 Shkurtin - Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Në këtë takim u diskutua për hapat që do të merren për planifimin e aktiviteteve të 17 Shkurtit, që programi të jetë sa më madhështor, ashtu siç është dita. Në mbledhje, mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, për ta dhënë mbështetjen e tij të prezervave.




Kryetari Latifi edhe këtë vit mori pjesë në aktivitetin për dhurimin e gjakut.

Dhurimi i gjakut, si akt human, eshtë tipar dallues i banorëve të Anadrinisë. Falë aktivistëve humanitarë u bë viti i pesëmbëdhjetë (15) që organizohet në fshatin Ratkoc. Pjesëmarrja masive e njerëzve të kësaj ane tregoi shpirtin e madh të tyre. Shpëtimi i jetes përbën thelbën e shpirtit njerëzor dhe anadrinasit e kane déshmuar me aksione të ngjashme humanitare, gjithandje në komunën e Rahovecit. Përgëzoj organizatorët, banorët e Anadrinisë dhe stafin e Qendrës së Transfuzionit të Gjakut për këtë aksion të suksesshëm.

Kryetari Latifi ka emëruar veprimtarin Dervish Çadraku, në Kabinetin e Kryetarit të Komunës, në pozitën zyrtar administrativ, respektivisht Këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së dhe vlerat kombëtare e historike. Emërimi i Çadrakut vjen pas vdekjes së Prof. dr. Sabahajdin Cenës, i cili për disa kohë e kreu këtë detyrë. Dervish Çadraku ka qenë i burgosur politik, venrimtar i cështjes kombëtare, ndërsa për vite me radhë ka udhëhequr shoqatën për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kombëtare „Arbëria”. Ditëve të fundit u zgjodh kryetar i degës së të burgosurve politik në Rahovec.





Ne Komunen e Skenderajt, me kolegë bashkepunetore, nënkyryetari Fatmir Iska, u mirëprit në takim nga Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura. Pas reshjeve të fundit atmosferike, të cilat kanë shkaktuar vërshime dhe probleme të tjera në Skenderaj, Kryetari z. Smajl Latifi ka marrë vendim që të themelohet "Fondi për Solidaritet për Zonat e përmbytura" për t'u solidarizuar me Skenderajn, andaj sot dorezuan donacionin me pako ushqimore e higjienike, nga ana e komunes se Rahovecit.

Kryetari i komunës, Smajl Latifi, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Avni Morina dhe zyrtarë komunalë nga kjo drejtori, kanë mbajtur takim me drejtorë të shkollave fillore të mesme të ulëta dhe të larta të Komunës së Rahovecit. Në këtë takim është diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor. Në fjalën e tij drejtori i Arsimit, Avni Morina, tha që sapo kemi filluar gjysmëvjetorin e dytë të mësimit dhe jemi në prag të festës së 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe me këtë rast janë paraparë të zhvillohen një varg aktivitetesh përkujtimore, kulturore dhe sportive. Ndërsa, kryetari Latifi, ka kërkuar nga të gjithë drejtorët që në koordinim të plotë me personelin arsimor, të angazhohen maksimalisht që të vazhdojë në mënyrë të rregullt mbajtja e procesit mësimor dhe të respektohet rendi shtëpiak në shkolla. I pranishëm në këtë takim ishte edhe komandanti i Stacionit të Policisë në Rahovec, z. Fazli Morina, i cili raportoi se detaje gjendja e sigurie në shkolla dhe ofroi bashkëpunim ndërmjet institucioneve për të rritur nivelin e sigurisë, sidomos në shkollat e mesme të larta.





Në palestrën e sportit "Mizahir Isma", në vigjilje te 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ka filluar spektakli i basketbollit në Rahovec. Rahoveci me ngrohtësi dhe krenari mirëpret organizimin e Final 8 të Kupës së Kosovës në Basketboll, të organizuar nga Federata e Basketbollit të Kosovës, në bashkëpunim me "KB RAHOVECI". Skuadrat më të mira të Prince Caffe Superligës, Superligës së Femrave dhe Ligës së Parë të Meshkujve do të garojnë për trofetë e çmuar, e ku do të ketë basketboll ciliçor dhe atmosferë sportive në tribuna. Kjo është një nga ngjarjet më të rëndësishme për basketbollin e Kosovës, andaj të gjithë pjesëmarrësve suksese!

Ne një atmosferë të forte sportive, por edhe te nxehet, "KB Rahoveci" ka arritur një fitore të pritshme e të merituar ndaj KB "Pejes" me rezultat 90 : 79, e cila përpos që i gëzoi të gjithë të pranishmit, ajo mban të forte edhe shpresen që të përjetojme fitore të reja të ekipit te Rahovecit në Final 8, të Kupës së Kosovës.



Komunës së Rahovecit, iu nda mirënjohje për miratimin e Planit të Integritetit, krahas komunave të tjera të cilat e kanë miratuar këtë plan, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në një ceremoni të përbashkët për komunat të cilat kanë miratuar Planet e Integritetit. Kryetari Smajl Latifi e pranoi Mirënjohjen nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi. Komuna e Rahovecit do të vazhdojë me përkushtimin dhe punën e qëndrueshme, në të mirë të qytetarëve të saj!

Shefi i Kabinetit, z. Ali Morina, bashkë me Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës, z. Afrim Oruqi, Drejtorin e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Albnor Mullabazi, Drejtoren për Punë Inspektuese, znj. Nora Boshnjaku, dhe zyrtarë nga zyra ligjore, zyra për barazi gjinore, pritën në takim perfaqësues nga USAID-i, si bashkëneshkrues të memorandumit të bashkepunimit per Qeverisje te Pronës. U diskutua mundesa e krijimit të hartes digitale për menagjimin e pronës komunale. Po ashtu u diskutua edhe infrastruktura ligjore e cila jo rralleherë po shkakton probleme dhe veshtrimet në dhënien e pronave në shfrytëzim. Bashkepunimi me USAID-in, ne këtë fushë, do të vazhdojë edhe më tej.



Ne kuadër të aktiviteteve ne prag te 17 Shkurtit - Dites së Pavarësisë së Kosovës, u mbajt Kuizi i Diturisë në lendën e Historisë me nxënësit e klasave XII. Në një garë të ngushtë dhe interesante ndërmjet ekipeve, vendin e parë e fituan nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë "Ukshin Hoti" me 28 pikë, ndërsa vendin e dytë e fituan nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë "12 Maji", me gjithësej 26 pikë.

Fondacioni "ADRIAN ORLLATI"-vjen në Rahovec me një veper te madhe humanitare dhe bëmirësie. Në 15-vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore, kryetari Latifi ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e objektit ~~për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të~~ shtyer ne moshe, investim ky për qellime krejt humanitare dhe bëmirësie, me njërin prej sipërmarrësve më të fortë e më të suksesshëm nga komuna jonë, z. Avni ORLLATI, respektivisht me Fondacionin "Adrian Orllati" me seli në Laussane të Zvicrës, të cilin e përfaqëson znj. Micheline Calmy Rey - Presidente e Fondacionit.





Në Seancën Solemne të Kuvendit Komunal, në 15-vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, kryetari Latifi, në prani të bashkëpuntorëve të tij, familjarëve, miqve dhe bashkëluftëtarëve, ka ndarë dekoratën "Medalja e lirisë" nga Komuna e Rahovecit, për dy bashkëluftëtarët e ndjerë VAJDIN BERISHA dhe SABAHAUDIN CENA.

U permbyll kampionati i basketbollit "FINAL 8 - KUPA E KOSOVËS", me ndeshjen finale ndërmjet ekipeve: KB Sigal Prishtina dhe KB Trepça. I pranishëmi sonte, me bashkepunëtore, me kryetarët, z. Përparim Rama, z. Bedri Hamza dhe me shumë adhurues të basketbollit, shijuam gjate seciles ndeshje kulturë sportive në nivel të duhur nga ekipet pjesëmarrëse. Gjatë gjithë këtyre ditëve, sportdashësit tanë, qytetaret e Rahovecit, dëshmuani se kanë një kulturre të lartë mikpritjeje dhe ofruan spektakël sportiv për të gjitha ekipet dhe tifozët që ishin të pranishëm në Palestrën Sportive "Mizahir Isma". Ndesha finale përfundoi me fitoren e ekipit të KB "TREPÇA" me rezultat: KB SIGAL PRISHTINA - KB TREPÇA 66:74.




#### PËRFUNDI MBLEDHJA E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA, E DYTA PËR KËTË VIT KALENDARIK.

Udhëhequr nga Kryesuesi Kafexhiu, sot, është mbajtur mbledhja e dyte e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023. Të pranishëm në mbledhje, nërvos kanëtarëve të komitetit, si zakonisht ishte edhe nenkryetari Iska dhe drejtorët e drejtoreve komunale. Mbledhja ishte konstruktive, ku për mbledhjen e rregullt të kuvendit u proceduan 20 pikë.

**EDHE NJË ZOTIM PUBLIK PO PËRMBUSHET**

Komuna e Rahovecit, në kuadër të shume zotimeve e ndihmesave që ka dhënë e jep për qytetarët e saj, kryen dhe shërbime periodike në vizita te fermerët blegtorë, mjekime të ndryshme me veterinarë të angazhuar, për bagëti të imëta, bagëti të trasha dhe qenë shtëpiakë. Kryetari Latifi, së bashku me drejtorin e DBPZHR-së, z. Berat Duraku, përcollën nga afér punën e përkushtuar nga veterinari dhe zyrtarë të Drejtorisë se Bujqesise, në procesin e vaksinimit të bagëtive të fermereve blegtorë të komunës sone.

Kontrolllet periodike do të vazhdojnë, si dhe drejtoria do të vazhdojë me punë të përkushtuara në të mirë të qytetarëve tane.



Kryetari Latifi, së bashku me stafin e tij, kanë mirëpritur në takim komandantin e KFOR-it italian për Rajonin Perëndim, z. Mario Bozzi me bashkëpunëtorë, si dhe përfaqësues të LMT-së në Rahovec. Në këtë takim, kryetari pasi e uroi komandantin Bozzi, përmarrjen e detyrës së re, diskutuan për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe kultivimin e mëtutjeshëm të raporteve të mira të bashkëpunimit, si dhe për përkrahje në projektet që janë në interes të qytetarëve tanë. Kolonelin Bozzi e falënderoi edhe për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre në mbikëqyrjen e sigurisë, me theks të veçantë, kur dihet se prania e tyre ndikon drejtëpërdrejtë në ruajtjen e paqs dhe stabilitetit në Kosovë.

**MBAHET MBLEDHJA E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE**

Ne prani te anetareve te Komitetit per Shendetesi dhe Përkujdesje Sociale, nën udhëheqjen e Kryesueses Vlora Vuçitëerna Çmega, u mbajt mbledhja e parë e komitetit për vitin 2023.

**RENDI i ditës ishte:**

1. Aprovimi procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për vitin 2023;
3. Të ndryshme.





Kryetari Latifi, së bashku me stafin e tij, ka mirëpritur në takim Konsullin e ri të Përgjithshëm të Turqisë në Prizren, Celal Doğan, në një takim njoftues, të cilit i dëshiroi mirëseardhje dhe e uroi për detyrën e re.

Kryetari Latifi i informoi për vazhdën e aktiviteteve komunale, investimet dhe punët që po vazhdojnë të bëhen, poashtu e falënderoi për përkrahjen dhe mundësinë e shtimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme.

#### PËRFUNDODI MBLEDHJA E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL TË RAHOVECIT, E DYTA PËR KËTË VIT KALENDARIK

Udhëhequr nga kryesuesi Defrim Kafexhiu, u mbajt seanca e dyte e rregullt për vitin 2023. Të pranishëm në seancë përvèç kuvendarëve, si zakonisht ishin edhe Kryetari i Komunës, Smajl Latifi, Nënkyryetari Iska, drejtoret e drejtorisive komunale, mediat që monitorojnë seancën, përfaqësuesit e KFOR-it dhe disa nxënës të Shkollës së Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici". Në rend dite ishin 20 pika.



## PËRFUNDIM

*Ky buletin përbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë muajit shkurt 2023.*

*Fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjërë, e një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror, është liria e informimit.*

*Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, porse i fuqizon qytetarët dhe mundeson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij buletini mujar ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'u dhënë mundësi qytetarëve që të njohin dhe të vlerësojnë punën e institucioneve komunale.*

*Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjeter përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.*

*Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.*

*Rahovec, shkurt 2023*